



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 33

Prishtinë, më 14.3.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popovic, Emilija Redzepi, Shaip Muja.

Munguan : Haxhi Shala, Salih Salihu dhe Lahi Brahimaj

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Duda Balje**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 9.3.2016,
3. Raportimi i ministrit të mjedisit lidhur me planin dhe prioritetet e ministrisë,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesja **Duda Balje** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;
Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa verejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 9.3.2016, Procesverbali i datës 9.3.2016 u miratua pa verejtje.

3. Raportimi i ministrit të mjedisit lidhur me planin dhe prioritetet e ministrisë,

Kryesuesja, e falënderoi ministrin e MMPH-së *Z. Ferid Agani*, që i është përgjegjë ftesës së Komisionit për raportim për punën e MMPH-së dhe e ftoi atë marrë fjalën.

Ministri Ferid Agani, fillimisht njoftoi se ministria është në fazën finale të përpilimit të rregullores së re të organizimit të brendshëm në të cilën parashihen disa ndryshime strukturore brenda ministrisë, në radhë të parë themelimi i Autoritetit të pellgjeve lumore, si autoritet ekzekutiv i paraparë më Ligjin e ujërave që do të ndihmojë dukshëm në menaxhimin e resurseve ujore. Rregullorja është në fazën e debatit publik dhe pritet që pas miratimit nga Ministria e administratës publike dhe Ministria e financave, të miratohet në Qeveri.

Më pastaj **ministri Agani** i'u përgjegj pyetjeve të Komisionit të dërguara më parë:

Për pyetjen e raportimit financiar: tha se buxheti i MMPH-së për vitin 2015 ka qenë 38 732 278 Euro, prej tyre si grante nga donatorët 738 509 Euro, financimi nga huamarrja 1 996 750 Euro, granti qeveritar ka qenë 35 997 000 Euro. Buxheti për vitin 2015 është realizuar 98, 48 %. Pjesa më e madhe e buxhetit 27 milion Euro ka shku për shpronësime, prandaj i gjithë buxheti i mbetur ka qenë rreth 11 milion Euro.

Ndërsa për **çertifikimin e auditit të brendshëm:** njoftoi se çertifikimi i auditorëve të brendshëm është një kërkesë ligjore dhe të gjithë auditorët përfshirë këtu edhe ata të MMPH-së kanë qenë të paisur me licenca të përkohshme që nga viti 2010 me afat 3 vjeçar, kurse me vendimin e Ministrit të financave të vitit 2013, të gjithë auditorët e sektorit publik që kanë qenë të paisur me licenca që janë pjesë e programit për çertifikim të auditorëve të brendshëm në sektorin publik, project i financuar nga BE-ja dhe atyre i'u është vazhduar afati i vlefshmërisë së licencës deri në përfundimin e programit për trajnim dhe certifikim. Dy auditorë janë pjesë e këtij programi ndërsa auditori I tretë është pranuar pas fillimit të këtij programi dhe është paisur me licencë të përkohshme.

Për **programin legjislativ** të miratuar nga qeveria, kanë qenë të parapara 6 projektligje dhe 57 akte nënligjore, janë nënshkruar 24 udhëzime administrative, 2 rregullore dhe janë miratu 3 udhëzime administrative qeveritare. Përmendi 3 si më të rëndësishme: *udhëzimi për përcjelljen e gazrave serrë, udhëzimi për mekanizmat e përcjelljes së gazrave serrë dhe udhëzimi për strukturën e pagesave të ujit*. Gjithashtu në qeveri është miratu *Projektligji për mbrojtjen nga zhurma* dhe është procedu në Kuvend. Sfidat kryesore për realizimin e programit legjislativ kanë dalë në përpilimin e tabelave të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. Mjedisi është një fushë shumë e rregulluar në BE dhe ktu kemi pasë vështirësi në përpilimin e ktyre tabelave të cilat kanë shkaktuar vonesa dhe që prej 6 ligjeve që kemi pasë në strategji kemi arritë të procedojmë vetëm një. Ndërsa tash janë të gatshëm edhe 5 projektligje të tjera. Një arritje e veçantë e MMPH-së në 2015 ka qenë reforma në planifikim hapësinor me miratimin e Udhëzimeve administrative për: *planin zhvillimor komunal, hartën zonale të komunës, hartën zonale të Kosovës si dhe udhëzimi administrativ për standardet dhe normat e planifikimit hapësinor*.

Në **sektorin e ujërave**, përfshirë vërshimet dhe cilësinë e ujit të pijshëm, është punuar mjaftë, mirëpo urgjenca është shumë e madhe dhe kërkon një angazhim edhe më të madh edhe të qeverisë dhe një koordinim edhe më të madh me Ministrinë e zhvillimit ekonomik kur është në pyetje furnizimi me ujë, trajtimi i ujerave të zeza, etj. Për vitin 2016 është parapa të investohet në rregullimin e shtretërve të lumenjëve, që është një masë parandaluese për vërshimet, konkretisht në shtretërit e lumenjëve: *Krena në Gjakovë (120 000 Euro), Lepenc në Kaqanik (150 000 Euro), Duhlllo në Rahovec (50 000 Euro), Rimnik në Rahovec (34 000 Euro), Drenica në Drenas (300 000 Euro), Bistrica në Pejë (100 000 Euro), Toplluha në Suharekë (100 000 Euro), në zgjerimin dhe pastrimin e lumenjve Llap dhe Batllavë në Podujevë (90 000 Euro), Sitnica në Lipjan (200 000 Euro) dhe në rehabilitimin e shtratit të lumit Klina në Klinë (55 000 Euro)*. Bëhet fjalë për investime që në relacion me buxhetin që e ka MMPH janë investime mjaft të mëdha, por në krahasim me nevojat në terren janë të vogla.

Sa i përket **cilësisë së ujit të pijshëm**, qëndrojmë mirë me standardet e cilësisë së ujit dhe kemi bashkëpunim të mirë me Institutin Kombëtar të shëndetit publik, po ashtu edhe ndërmarrjet rajonale për furnizim me ujë kanë këtë bashkëpunim i cili bazohet në *Udhëzimin administrativ 16/2012 për cilësinë e ujit të pijshëm*, ndërsa furnizimi me ujë të pijshëm është në përgjegjësi të ndërmarrjeve publike që janë në kompetencë të Ministrisë së zhvillimit ekonomik.

Trajtimi i ujëravë të zeza, në periudhën e pasluftës ka ngelë në fund të prioriteteve që janë marrë komunat dhe qeveria, kjo ka mbetë një qështje emergjente mjedisore me të cilën duhet të ballafaqohemi. Janë bërë përgatitjet e duhura, janë kry studimet e fizibilitetit për impiantet në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Rahovec si dhe janë punu 8 studime fizibiliteti në zonat rurale të punuara me mbështetjen e Agjencionit zvicrran për zhvillim. Impianti në Prizren ka fillu të ndërtohet, për këtë është nënshkru kontrata, janë përgatitjet për nënshkrimin e kontratës në Gjakovë, dhe në Pejë. Në pellgun e lumit Drin kemi siguru një projekt donator me vlerë *1 milion Dollar* nga GeF (*Global Environment Facility*) dhe këto mjete realizohen përmes UNDP-së, sepse nuk kem pasë të drejtë aksesit të drejtëpërdrejtë në këto fonde. Në kuadër të këtij projekti në vlerë prej *200-250 mijë Dollar* është propozu pilotprojekti për ndërtimin e fabrike për trajtimin biologjik të ujërave të zeza në fshatin Kramovik në komunën e Rahovecit. Jemi në kërkim të modelit për fabrikën e ujërave të zeza për Prishtinën, janë disa opsione të cilat jemi duke i shqyrtu së bashku me Ministrinë e financave dhe po ashtu janë duke u bërë përpjekjet edhe për Gjilan, Mitrovicë dhe Ferizaj. Në fokus ka qenë edhe gjetja për trajtimin e ujërave të zeza në liqenin e Batllavës, kemi arritë të sigurojmë një investim për ndërtimin e impiantit me ndihmën e Agjencionit zvicrran për zhvillim. Janë ndërtuar disa impiante më të vogla, në Skenderaj, Pallatin e drejtësisë në Prishtinë, Harilaq, Kompleksin e burgut Dubrava, Lipjanit etj.

Për çështjen e shpronësimeve, ministri tha se një arritje e madhe është miratimi i vendimit për aplikimin e softërit për regjistrimin e të gjitha pronave të shpronësuar dhe tash e tutje çdo institucion do të dërgojë të dhënat dhe do të bëjnë transparente dhe do të ndikojë dukshëm në cilësinë e menaxhimit dhe do të parandalojnë shumë dukuri eventuale negative dhe keqpërdorime. Ky softëer mundëson njëkohëshiht të shiqojë në retrospektivë në periudhën e kaluar në shpenzimet e mjeteve financiare nga ministrinë

përkatëse, ne e dimë se tri ministri janë të kyqura në procesin e shpronësimit përveq ministrisë tonë edhe ajo e ifrastrukturës dhe e financave.

Në departamentin e shpronësimeve sfidë kryesore për zbatimin e ligjit për shpronësim kanë qenë ndarjet buxhetore më të pakta në krahasim me nevojat reale. Obligimet në fund të 2015 për kompenzimin e pronave janë **145 571 431 Euro**. Prej tyre për Prona private (54 422 000 Euro), prona komunale (13 534 000 Euro), prona shoqërore (45 454 000 Euro), prona publike (15 503 000 Euro) dhe për objektin e Rilindjes (16 605 000 Euro). Kërkesa buxhetore për vitin 2016 është bërë në vlerë prej 45 milion Euro ndërsa ndarja buxhetore është në vlerë 27 145 000 Euro. E njëjta situatë ka ndodhë edhe në 3 vitet paraprake dhe për këtë ka ardhë deri te grumbullimi i këtyre obligimeve. Në vitin e kaluar është përpiluar dhe ka hy në fuqi *Udhëzimi administrativ për regjistrin e pronave të shpronësuara 18/2015*, kjo ka krijuar bazë ligjore për procesin e regjistrimit të pronave të shpronësuara të zbatohet shumë më shpejtë. Sepse kemi shumë prona të shpronësuara ende kanë ngelur në emër të pronarëve të vjetër pas kryerjes së shpronësimit. Kemi raste kur palët nuk qenë të knaqura me nivelet e vlerave financiare të caktuara për shpronësim dhe kane inicuar raste gjyqësore.

Për Agjencionin Kadastral të Kosovës, e rëndësishme është se është duke u bërë rindërtimi i kadastrit si në nivelin komunal edhe qendror, pastaj gjeoportali që mirëmbahet nga Agjencia është duke u pasuruar me të dhënat e duhura dhe paraqet një cilësi të re të punës.

Për Projektligjin e Obiliqit, MMPH-ja ka marrë pjesë në punën e komisionit parlamentar dhe ka dhënë kontributin e vet, ky projektligj me të gjitha kundërthëniet e tij të cilat i ka pasë për shkaqe të ndryshme, nga perspektiva e MMPH-së nga njëra anë është vlerësuar se objektivat e tij kanë mund të arrihen edhe me zbatimin e legjislacionit për mjedis në fuqi, por duke pasë parasysh ndjeshmërinë e vonësave në adresimin e çështjeve mjedisore në komunën e Obiliqit si në aspektin e cilësisë së ajrit, mbeturinave, etj, atëherë ne kemi dhënë kontribut maksimal në përpilimin e këtij Projektligji dhe në miratimin e tij në Kuvend. Gjatë punës kanë dalë vështirësi të natyrave të tjera, në radhë të parë me përshtatjen me legjislacionin financiar që është në fuqi dhe ne qëndrojmë të gatshëm të japim kontributin tonë edhe më tej, pas gjetjes së zgjidhjeve për çështjet financiare që janë të ngritura nga Ministria e financave.

Do të theksojë edhe këto dokumente shumë të rëndësishme që pres të miratohen: *Plani i veprimtimit për parandalimin e keqpërdorimit të inerteve nga lumenjtë*, ku përfshihen detyrat dhe obligimet ligjore të 11 institucioneve, të cilin pres të miratohet në qeveri brenda këtij muaji. Dokument i dytë është, *udhëzimi administrativ për kontrollin e emisionit të gazrave nga burimet e lëvizshme*. Ky udhëzim ka qenë i miratuar që nga viti 2012 dhe qëllimi i tij ka qenë që me rastin e regjistrimit të automjeteve të bëhet edhe matja e emisioneve të gazrave, mirëpo nuk e ka gjetë zbatimin asnjëherë. Sapo të miratohet parashihet që të fillon një fazë 6 mujore e pilotimit me të cilin do të vendoset standardi euro 3 në qendrat e kontrollit teknik për matjen e këtyre emisioneve. Shpresoj se me zbatimin e sukseshëm të këtij udhëzimi do të ndikojmë dukshëm në cilësisë e ajrit, kur e dime se rreth 27% e ndotjes së ajrit në qendrat urbane vijnë nga emisionet e gazrave nga automjetet. Po ashtu edhe *Udhëzimi administrativ për gjobat mandatore për ndotjen e mjedisit*, që ka ekzistuar me herët por që nuk ka gjetë zbatimin e duhur, kesaj radhe të

plotësuar me obligimin ligjor të Policisë së Kosovës të ndihmojë inspektoratet në nivelin komunal dhe qendror.

Kryesuesja, pasi e falenderoi ministrin, shtoi se ka disa pyetje dhe i ftoi deputetët të bëjnë pyetje dhe ministri në fund të ju përgjigjet;

- *Rreth ujit të pijes, pasi thatë se keni nën kontroll kualitetin e ujit të pijshëm dhe bashkëpunoni me Ministrinë e shëndetësisë, sa laboratore kemi dhe kush i bën analizat e ujit, e di se në Prizren këtë e ka bërë spitali shtetëror dhe ata nuk kanë pasë reagenca për të bërë këtë ?*
- *Kosova është atraktive për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla, cili është bashkëpunimi më nivelin lokal ?*
- *Për menaxhimin e pyjeve në parqet nacionale, cili është koordinimi me Ministrinë e bujqësisë dhe a jeni dakorduar për menaxhimin e pyjeve në parqe nacionale?*

Adem Salihaj, tha se ne i kemi dërgu paraprakisht ministrit disa pyetje dhe të gjitha përgjegjjet janë në bazë të pyetjeve që i kemi bërë paraprakisht. Përveq tjerash përsëriti pyetjen se *Cilat kritere i ka pasë MMPH për shpërndarjen e investimeve kapitale?* Mirëpo në webfaqen e ministrisë është e publikuar një hartë e projekteve të investimeve kapitale dhe duket sikur orientimet e ministrisë janë në rrafshin e dukagjinit, dominojnë Prizreni, Gjakova, Peja, Rahoveci, Suhareka, Malisheva edhe një pjesë e Drenicës dhe në pjesë tjera të Kosovës ka shumë pak ose ska fare investime, Psh. veq komuna e Ferizajt i jep buxhetit të Kosovës 100 milion Euro taksa kurse ka marrë një shumë të vogël që s'ja vlen të përmendet. Dmth nuk ka qenë një kriter i drejtë i ministrisë për ndarjen e investimeve. Dëshiroj të di arsyet pse ndodhë ky orientim i investimeve në atë pjesë të Kosovës?

- *Nga 6 projektligjet e planifikuara për vitin 2015 asnjë nuk është procedu në Kuvend dhe Komisioni nuk ka arritë të realizojë planin e punës për shkak të dështimit të agjendës së MMPH-së, po ashtu edhe ministria e bujqësisë ka dështuar njejtë.*
- *Derdhja e ujërave të zeza në liqenin e Batllavës është për tu shqetësuar, nga i cili një regjion shumë i madh furnizohet me ujë të pijshëm, ky shqetësim që duhet të ketë prioritet në MMPH?*

Murat Hoxha, për çështjen e shpronësimeve tha se grupi punues për ndryshimin e këtij ligji është duke punu dhe ka identifikuar nevojën esenciale për të ndryshu këtë ligj si dhe shtroi këto pyetje për ministrin:

- *300 milion Euro vlera të pronave të shpronësuara nuk janë regjistruar, ministri e përmendi se është nxjerrë një udhëzim administrativ dhe a keni bërë analizë a ka qenë pengesë për këtë ky udhëzim administrativ, apo qështje të tjera dhe pse ky udhëzim administrativ nuk është nxjerrë para 4 vite bashkë me ligjin për kadastrë dhe kur ka fillu shpronësimi?*
- *Për rindërtimin e të dhënave kadastrale, janë diku 100 zona kadastrale në proces të rindërtimit prej gjithsej 1305 zonave dhe nëse vazhdon kjo dinamikë atëherë ky proces do të zgjasë edhe 100 vjet?*

- *Për implantet e ujërave të zeza, rikujtoi se para një viti ministri ka thënë në komision se tash po shkon me bisedu për implantin në Gjilan, Gjakovë, Pejë, Prizren dmth prej tyre ka fillu veq një ku është problemi. A është bë fizibiliteti për nevojën e impianteve për Kosovën dhe për sa impiante ka nevojë Kosova?*
- *Për Ligjin e Obiliqit, ne kemi ardhë në një pikë ku nuk dimë se cka të bëjmë me këtë, sepse MMPH dhe Ministria e financave ka thënë se nuk duhet aprovuar ky Ligj.?*
- *Për një iniciativë të mëhershme të Agjencionit Kadastral të Kosovës dhe që e kanë shume shtete të rajonit që Ligji për kadastër, Ligji për të drejtat e pronës dhe Ligji për hipotekat, të bëhet një ligj dhe sa është duke u punu në këtë drejtim?*
- *Legalizimi, nëse janë dorëzu 400 mijë aplikacione dhe tash janë 600 aplikacione për legalizim kjo konsiderohet dështim. Ku është problemi që nuk po shkon mirë legalizimi, a është problemi të legjislacioni, te strategjia, te metoda? pse nuk është marr modeli i Maqedonisë ka qenë i mirë të merret ky model?*
- *Ka i bie traseja e autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i bardhë, apo këtë e din veç Ministria e Infrastrukturës?*
- *A mendoni se duhet të themelohet Oda e gjeodetëve të Kosovës?dhe a ka mundësi që kjo të themelohet sa më shpejt, sepse është në interes edhe të ministrisë suaj dhe të gjithë qytetarëve?*

Emilija Redzeqi, e falenderoi ministrin për raportimin sidomos atë financiar për 2015, sepse siq tha ajo kemi informata se një numër i madh i projekteve nuk janë kry dhe shumë mjete financiare kanë shku në suficit dhe shtroi këto pyetje:

- *Cka mendoni për Projektligjin për zhurmën?*
- *Një problem që e mundon ndërmarrjen publike Hidroregjioni jugor që përfshinë edhe banorët e Malishevës, Suharekën dhe Dragashin rreth ujit të pijshëm dhe ajo cka është konkrete kompetencat që ndërlidhen më ndërmarrjen tjetër për ujitjen e tokës bujqësore Dukagjini dhe që ndikon jo mirë në popullatën tonë sepse nuk janë të përfshirë banorët e Suharekës, Malishevës dhe Dragashit dhe bujqit ballafaqohen me probleme për ujitje. Përgjegjësia e Ministrisë së zhvillimit ekonomik a ka mundësi ndërmarrja publike Dukagjini të integrohet në Ndërmarrjen Publike Hidroregjioni jugor, që më lehtë do të kishte funksionu si për ujin e pijshëm ashtu edhe për ujitjen e tokave bujqësore?*
- *Zona e Zhupës nuk është në sistemin e Hidroregjionit jugor, cila është strategjia e juaj për ta kyqë në sistem këtë zonë me 13 mijë banorë 14 vendbanime dhe cili do të jetë çmimi i shërbimeve nga ana e tyre sepse nuk mund të jetë e njejtë me komunat e tjera për shkak se ata vetë e kan financu rrejtin e ujësjellësit?*

Shaip Muja, shtroi këto pyetje për ministrin:

- *Kemi hasur në vërjetje në terren për kompanitë që janë paisur me leje të integruara, deri në cfarë mase i kanë plotësu kushtet për këto leje ? Po ashtu ka disa kompani të vogla në rrugën Prishtinë-Ferizaj që janë 3 vatra kontaminuese të ambientit, ai inspekton dikush ata ?*

- *Për Projektligjin e Obiliqit kemi hasë në probleme që kanë ardhë nga Ministria e finanacave dhe MMPH, problemi kyq këtu është tantiema dhe s'kemi marrë përgjegjje asnjëherë, edhe pse kemi tentu që projektet ti ndajmë në zëra nëpër ministri të ndryshme, mirëpo deri më tash nuk kan arritë asnjëra ministri, si MMPH, Ministria e zhvillimit ekonomik, e bujqësisë, e kulturës e shëndetësisë që në aspektin strategjik planin 5 vjeçar të zhvillimit dhe detyrave që kanë.*
- *Instituti i mjekësisë së punës në Obiliq, të shëndrrohet në njësi të shërbimit primar dhe të kalojë në kuadër të MSH si aset, a është diskutu kjo në qeveri?*
- *Për demarkacionin, sa keni qenë ju si ministri të involvuar në këtë proces, sepse ende nuk pe kuptojmë në Kuvend se cili komision duhet mu marrë me këtë dhe cila ministri është dashtë me u marrë me këtë? Ne kemi kërkuar që materiali i komisionit qeveritar të jetë në komsionin tonë, e ai nuk ka ardhë ende në Kuvend, që ne ta trajtojmë në komision me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtar dhe ta gjejmë një spjegim real për këtë situatë. Involvimi i Presidentes në këtë proces është një gabim juridik dhe me këtë po dërgojmë mesazh të gabuar në popullatë dhe në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, se nuk po i dijmë rolet. Prandaj pse qeveria nuk e ka sjellë këtë material dhe cili ka qenë angazhimi i juaj si ministri?*

Srdjan Popovic, shtroi këto pyetje për ministrin:

- *Ingerencat e MMPH për zonat e mbrojtura të Hoqës së madhe dhe qendrën historike të Prizrenit dhe çka është duke u bërë për këtë?*
- *A planifikoni vizitë zonave që janë vëshuar, psh. komunën e Ranillugut dhe Graqanicës?*
- *Në komunën e Graqanicës më kanë thënë se ka një kod bugjetor për sanimin e kanalizimit të ujërave atmosferik, kur do të realizohet ky projekt ?*

Ministri Agani, tha se Ministria e ka një portfolio mjaft të gjerë në mënyrë që me ju përgjigjë të gjitha sfidave që i ka vendi në fushën e mjedisit dhe të planifikimit hapësinor dhe filloi të përgjigjet në pyetjet e parashtuara nga deputetët:

- ***Për cilësinë e ujit të pijes***, në Republikën e Kosovës sigurohet në një bashkëveprim të laboratorëve përkatëse në radhë të parë të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe 7 qendra rajonale të paisur me laboratorë përkatës që raportojnë në mënyrë të rregullt dhe qytetarët janë të sigurtë dhe se në çdo moment mund të jenë të informuar për cilësinë e ujit të pijshëm. Këto laboratore janë në bashkëveprim edhe me laboratorët përkatës të ndërmarrjeve publike rajonale të cilat merren me furnizim me ujë.
- ***Për Hidrocentralet në Komuna***, në procedurat e nxjerrjes së lejeve, MMPH është njëra prej hallkave në këtë zingjir dhe atë në segmentin kur duhet dhënë vlerësimi i ndikimit në mjedis për këto hidrocentrale. Asnjë pëlqim mjedisor nuk lëshohet nga ministria pa u bërë debati publik me komunitetin dhe pa pasë një leje përkatëse nga Asambleja komunale e cila e miraton fillimin e ndërtimit.
- ***Për pyjet dhe kompetencat rreth menaxhimit me pyjet*** në mes të Ministrisë së bujqësisë dhe MMPH-së, konkretisht Projektligji i ri për pyjet është në proces në Ministrinë e bujqësisë, ne i kemi disa dilema ende lidhur me qartësimin e plotë të kompetencave të drejtorive të parqeve kombëtare të cilat në bazë të ligjit për parqe

kombetare kanë kompetencë të plotë të menaxhimit në hapësirat e parqeve kombëtare. Ka qenë qëndrim i ministrisë tonë, që Agjencioni i Pyjeve të ketë përgjegjësi të plotë për masën drusore, ndërsa kur janë në pyetje veçoritë e tjera biodiversiteti, flora dhe fauna të jenë në kompetencë të drejtëpërdrejtë të drejtorive të parqeve kombëtare. Mirëpo në draftin e fundit këto kërkesa të MMPH-së nuk janë adresu në mënyrë të plotë dhe ne do të instistojmë që ky projektligj para se të shkojë në qeveri të kemi harmonizim të plotë mes dy ministrive.

Shaip Muja, ndërhyri me një pyetje për ministrin, *për mbeturinat e pyjeve dhe shfrytëzimi i tyre për industrinë e prodhimit të peletit dhe riciklimi i tyre është i dobishëm gjithashtu për prodhimin e energjisë. Çfarë plani keni për këto mbeturina që mbesin nga pyjet sepse nuk jam tu pa ndonjë strategji nga MMPH as nga Ministria e bujqësisë që do të jenë të dobishme nga aspekti ekonomik dhe i punësimit, kto kompani të peletit.*

Ministri Agani, i'u përgjegg se duhet të punohet më shumë me parqet kombëtare dhe nuk ka ende një projeksion të qartë të zhvillimit ekonomik brenda parqeve, përfshirë zhvillimin e turizmit dhe shfrytëzimit të resurseve tjera natyrore, që mund të behen pa e cenuar mjedisin. Pajtohem me ju dhe ne do të inicojmë ndryshimin e plotësimin e këtyre ligjeve të parqeve kombëtare dhe do të parashohim një aktivitet ekonomik në zonën e tretë, ku do të përfshihen edhe këto lloj aktivitete ekonomike.

- ***Për kriteret e investimeve kapitale të MMPH-së***, Kur e kemi përpilu kornizën e buxhetit për 2016, Ministria e i ka pasë në dispozicion vetëm 200 mijë Euro për projekte të reja. Të gjitha investimet tjera kapitale kanë qenë vazhdim i projekteve të inicuar më herët. Ajo që na udhëheq në përcaktimin e politikave të investimeve janë strategjitë përkatëse dhe ne duhet ti ndjekim ato në të cilat është parapa një zhvillim harmonik në tërë territorin e jo sipas krahinave ashtu siq e keni vërejtë ju. Fakti se kemi buxhet të vogël për investime kapitale në sektorin e mjedisit, na detyron që të mvaremi edhe nga interesat e ndryshme të donatorëve. Konkretisht mundësitë e financimit në impiantet e ujërave të zeza në Gjilan ekziston mundësia të financohet nga huaja e butë e qeverisë Austriake, po ashtu edhe në komunën e Podujevës. Projeketet ndërkufitare rasti i projektit të Drinit 1 milion dollar i ofruar nga **GEF** si projekt që e trajton lumin Drin, si lum ndërkombëtar. E përmendët Ferizaj në këtë kontekst dhe plotësisht pajtohem, i vetmi projekt ka qenë Bifurkacioni me një shumë simbolike 25 mijë euro. Me themelimi i fondit për mjedisin, për të cilin kërkojmë edhe mbështetjen e Komisionit për këtë ligj, tha se jam optimist se deri në fund të vitit do të realizohet, ne do të kemi më shumë mundësi që të realizojmë strategjitë dhe politikat tona.
- ***Projektligji për mbrojtjen nga zhurma***, është ripunu nga fillimi në ministri dhe i ka të përfshira të gjitha rekomandimet e komisionit funksional nga legjislatura e kaluar.
- ***Pse nuk e kemi arritë që 5 projektligje të tjera me i realizu***, arsyeja është kërkesat e Komisionit Evropian për tabelat e përputhshmërisë me *acquis communautaire* dhe kjo ka qenë problematike dhe ka marrë kohë, për shkak se është dashtë të trajnohet stafi. Tash janë ngritë kapacitetet dhe 5 projektligje janë të gatshme.
- ***Ujërat e zeza në Liqenin e Batllavës***, kjo ka qenë prioritet i punës sime dhe në buxhet nuk kemi pasë mjete dhe tash e kemi siguru donacionin me rreth 25 mijë euro nga

Agjencioni zviceran për zhvillim për ta adresu këtë problem gjatë këtij viti. Për momentin uji është i sigurtë nga Batllava, pra është 100% i sigurtë sa i përket cilësisë.

Adem Salihaj, shtoi se ka disa vite që ne i bëjmë ligjet tona në përputhshmëri me legjislacionin e BE-së dhe krejt ministritë e bëjnë këtë, e na dërgojnë një lloj shkrese që projektligji është në përputhje me legjislacionin e BE, më habit fakti pse kjo nuk është aplikuar të ministria e juaj.

Ministri Agani, i'u përgjegy se deklarata e Ministrisë së Integritit Evropian që është lëshu më herët ka qenë një deklaratë që është përmbledhë në tre rreshta pas analizave që ata i kanë bërë legjislacionit të BE dhe me një përshtypje të tyre e kanë dhënë mendimin. Kjo tash është procedurë krejtësisht e re ku duhet të përpilohen tabelat e përputhshmërisë dhe tash është nxjerrë rregullore e re e qeverisë pra është një procedurë e re adative.

Arben Çitaku, sekretar i MMPH-së, vazhdoi në lidhje me këtë pyetje duke bërë krahasimin mes viteve 2014 dhe 2015. Kur është hartu strategjia legjislative e ministrisë kanë qenë rregulla tjera të dërgimit të ligjeve nëpërmes qeverisë në Kuvend. Në 2015 kjo është ndryshu si pasojë e kërkesës së Komisionit Evropian. Ne raportojmë çdo vit për MSA për secilin ligj dhe deri në vitin 2014 ka qenë vetëm një përmbledhje e transpozimit të direktivave të BE-së brenda legjislacionit tonë. Ndërsa në 2015 ka ndryshu dhe janë futë tabelat e përputhshmërisë të cilat bëhen në tri gjuhë, Psh vetëm për ligjin e ajrit ne i kemi përgatitë 42 tabela të tilla të përputhshmërisë në 3 gjuhë dhe kjo është një punë voluminoze dhe teknikisht nuk kemi mujtë me mbërriri në kohë. Edhe vetë Ministria e integritimeve vetë nuk ka qenë sa duhet e përgatitun, sepse ata janë përgjegjës për lëshimin e këtyre deklaratave të përputhshmërisë.

- **Në lidhje çështjen e zbatimit të udhëzimit administrativ dhe rindërtimit të informacioneve kadastrale**, ministri Agani ftoi përfaqësuesit nga Agjencia Kadastrale e Kosovës të japin përgjegje. **Ismet Kryeziu nga Agjencioni Kadastral i Kosovës**, u përgjigj se të gjitha kadastrat kanë punu në mënyrë të pavarur edhe pa këtë udhëzim, mirëpo pasi u rrit numri i lëndëve të shpronësimeve në dy autostradat, ne e kemi pa të arsyeshme të japim instrukcionet përmes këtij udhëzimi si të bëhet ana teknike prandaj Udhëzimi nuk ka qenë pengesë por vetëm shtytje dhe ka sjellë lehtësira në punë.
- **Çështja e rindërtimit të informacioneve kadastrale**, në fillim ka nisë me shpenzimet e qeverisë si pilot projekt pasi që u pa se kemi shumë ndërrime të pronave, parcellave dhe mungesës së dokumentacionit që janë marrë nga Serbia. Ne kemi parapa në fillim që të nisim rreth zonave urbane ku kemi pasë më shumë ndryshime. Agjencioni Kadastral së bashku me komunat i kanë caktu prioritetet se cila zonë duhet të jetë prioritet dhe kemi zgjedhë ato zona ku ka më shumë ndryshime. Duke i falënderu Bankën Botërore vitin e kaluar i kemi kry 50 zona dhe sivjet jemi në procedurë edhe 20 zona kadastrale. Kemi edhe shumë zona dhe kërkojnë mjete më shumë, prandaj prioriteti i Agjencisë dhe i Qeverisë është që rindërtimi i informacioneve kadastrale të bëhet në ato zona ku ka pasë më shumë ndryshime.

Kryesuesja, ndërhyri, në lidhje me këtë temë propozoi që për shkak të interesimit në këtë temë të ftojme në një takim tjetër Agjencionin Kadastral, me të cilën u pajtuan edhe të tjerët.

Ministri Agani, tha se për herë të parë gjatë viti të kaluar kemi përpiluar regjistrin shtetëror të ndërtimeve pa leje me 352 mijë ndërtime pa leje, afatat kohore që kanë qenë të përcaktuara më ligjin në fuqi kanë qenë të ngushta konkretisht ligji parasheh që të gjitha aplikacionet të realizohen deri më 16 mars, ndërsa numri i aplikacioneve ka qenë shumë i ulët për shkak të cmimit, që po del të jetë mjaftë i lartë për qytetarët. Ia ka fillu që 6 muaj të punojë në ndryshimin dhe plotësimi i këtij Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje është duke u përgatitë dhe së shpejti do të procedohet.

Arben Çitaku, sekretar i MMPH-së, për modelin e Maqedonisë, tha se ka qenë i mirë në aspektin financiar për shkak se atje ka qenë *1Euro për m2*, specifikat e Maqedonisë nuk kanë qenë të njejta më Kosovën, për shkak të luftës. Numri i dokumentacioneve për aplikim dhe cmimi kanë dalë problematike për zbatimin e këtij ligji dhe këtë e kemi adresu në Ligjin e ri që është në përgatitje.

Ministri Agani, për themelimin e odës së gjeodetëve, njoftoi se koncepti dokumenti i *Projektligjit për odën e arkitektëve dhe inxhinierëve*, është i gatshëm për miratim në qeveri, dhe në kuadër të këtij ligji duhet pa mundësinë e themelimit të kësaj ode. Ndërsa për *udhëzimin administrativ për pagesat ujore* tha se ky udhëzim nuk e rregullon qështjen e çmimit të ujit për amvisëri, sepse kjo është në kompetencë të rregullatorit të ujit.

- Sa i përket ***pyetjes për hidroregjionin***, kjo është në kompetencë të Ministrisë së zhvillimit ekonomik, ndërsa përgjegjësia e MMPH-së është leja ujore.
- Rreth ***punes së inspektoriatit***, tha se ata duhet të fuqizohen edhe më shumë për të përballu me sfidat në terren si për nga numri ashtu edhe aisjet e nevojshme për ti kry me sukses detyrat që i kanë.
- Është një përmirësim i ***monitorimit të cilësisë së ajrit***, ne kemi bërë një ridizajnim të rrjetës së stacioneve për kontrollin e cilësisë së ajrit në vend dhe presim një monitorim më të mirë të cilësisë së ajrit.
- ***Për Projektligjin e Obiliqit***, nga perspektiva e MMPH ky ligj konsiderohet i panevojshëm sepse mendohet se me zbatimin e ligjeve aktuale në fuqi mund të arrihen objektivat e njejta. Mirëpo për shkak të moszbatimit të mjaftueshëm të këtyre ligjeve e kam mbështetë nxjerrjen e këtij ligji duke u nisë nga interesat e qytetarëve të komunës së Obiliqit. Mirëpo problemet reale dalin në fushën e financimit dhe kjo është në kompetencë të MF..
- ***Çështja e Institutit të mjekësisë së punës***, ideja ime sa kam qenë ministër i MSH-së, ka qenë e njejte që ky institut të del në kompetencës së MSH, mirëpo nuk kemi mbërri në atë mandat, mirëpo ekziston mundësia dhe motivacioni edhe të gjithë akterët dhe nuk shoh asnjë arsye të mos realizohet.
- ***Rreth demarkacionit***, MMPH nuk ka pasë ndërhyrje aktive në këtë proces, sepse ka qenë komisioni shtetëror i ngritur nga qeveria kompetent për këtë. Komisioni e ka paraqit raportin në qeveri që është miratu dhe kemi konsideru se është çështje e komunikimit ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit. mirpo para se ky raport të behët subjekt i diskutimit edhe në komisionin tuaj që të rishqyrtohet edhe një herë dhe këtu e shoh ndërhyrjen e presidentes në bazë të kompetencave të saja kushtetuese, në mnyerë që të shihet se ky raport të jetë në pajtim edhe me vlerësimet ndërkombëtare dhe kur të vjen ai raport në komision ju të jeni sa më shumë të informuar për këtë

cështje. Unë e shoh si pozitive këtë dhe si një kontribut që do të ndihmon Kuvendin që të merr mendimin ma meritë.

- *Ministria është e involvuar në procesin e nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet komunës së Mitrovicës së Veriut, Mitrovicës së jugut, MAPL dhe MMPH-së* kur janë në pyetje zbatimi i planit zhvillimor komunal, hartës zonale komunale dhe përcaktimit dhe përcaktimit të linjës administrative ndërmjet dy komunave që ka dalë edhe nga marrëveshja e Brukselit.
- ***Për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Hoqën e madhe dhe Ligjit për qendrën historike të Prizrenit,*** është ngritë një task forcë për këtë, këshilli i fshatit Hoqë e madhe është themelë dhe kemi rezultate të mira. Ndërsa për qendrën historike të Prizrenit task forca ka identifikuar 42 objekte që kanë tejkalime dhe shkelje ligjore.
- ***Për vizitat nëpër komunat të cilat janë të vërsuara,*** e kam bërë edhe ne të kaluarën si në komunën e Vitisë do të vizitojmë edhe këto komuna, Agjencioni i Emergjencave është kompetente, ndërsa ne do të investojmë në rregullimin e shtretërve të lumenjëve, për parandalimin e vërshimeve.
- ***Çështja e realizimit të projektit të ujërave të zeza në Çaglavicë,*** është në implementim e sipër projekti në vlerë 200 mijë Euro, ne do të propozojmë udhëheqjes komunale që ta menaxhojë vetë, së shpejti do ta nënshkruajmë memorandumin për zbatimin e këtij projekti në mes të MMPH-së dhe komunës së Graçanicës.
- ***Për blloqet e Termocentralit A,*** me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, janë obligime ndërshtetërore, ne kemi dhënë një propozim se si mendojmë me adresu këtë qështje. Demontimi i kapaciteteve të termoelektraneve do të jetë shumë i vështirë në pajtim me marrëveshjen që ka arritë Kosova me traktatin e komunitetit të energjisë për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe shteti nuk mund të vjen në situatë që të ngel pa kapacitete energjetike. Termoelektrana Kosova e re me teknologjinë e cila do të instalohet nga aspekti mjedisor i plotëson të gjitha standardet ndërkombëtare mjedisore. Ndërsa në pyetjen e deputeti *Shaip Muja*, se a është është fut Kosova në krizë të thellë energjetike me pranimin e rrënimit të 5 blloqeve të termocentraleve, **ministri Agani**, u përgjigj se dialogu ndërmjet Kosovës dhe BE-së lidhur me këtë qështje është në vazhdimësi e sipër dhe nuk është interes i BE-së me lënë Kosovën pa rrymë, mirëpo ne do të jemi të vëmendshëm se cilat do të jenë implikimet mjedisore të vendimeve që do të merren.

Murat Hoxha, shtoi edhe dy pyetje shtesë: *pse nuk dihet ende traseja për Autostradën e Prishtinës-Gjilan-Dheu i Bardhë, dhe për rrugën qarkore në Gjilan që prej 16 vjetëve e identifikon komunën si uzurpatorë të pronës sepse nuk e ka pagu dhe ska përgjegjë për këtë?* **Arben Çitaku**, i'u përgjigj se MMPH-ja konform planit hapësinor të Kosovës është përgjegjëse të caktojë koridoret ku zhvillohen projektet, ndërsa Ministria e infrastrukturës i cakton prioritetet dhe në bazë të analizës së fizibilitetit e bën projektin dhe me atë projekt e aplikon në MMPH për vlerësim të ndikimit në mjedis të kësaj rruge dhe kjo nuk ka ndodhë ende. Ndërsa për rrugën qarkore, ne jemi përgjegjës për shpronësimin e tokave në nivel nacional dhe në këtë rast është kompetencë e Komunës së Gjilanit.

Duda Balje, falendëroi ministrin Agani dhe të tjerët për pjesëmarrje.

4. Të ndryshme

- **Komisioni i rekomandoi Kuvendit të miratoj në parim Projektligjin Nr.05/L-091 për për mbrojtjen nga zhurma.**
- **Komisioni caktoi mbajtjen e intervistës për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit, që do të zhvillohet të hënën më 21 mars 2016 në ora 10:00.**

Mbledhja përfundoi në ora 13:25

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Duda Balje